



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2981 Prot

Shkodër, më 23 . 09 .2025

Lënda: Publikim njoftimi për vende të lira pune

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**


(Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike të radhës, për dy vende të lira pune në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", kategoria personel ndihmës akademik me karakter administrativ, pozicionet "Specialist i Kurrikulave" dhe "Asistent i Rektorit".

Sipas kërkesës suaj, gjeni dhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

**REKTORI**

**Prof. dr. Tonin Gjuraraj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2981 Prot

Shkodër, më 23 . 09 .2025

**N J O F T I M**

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi për 2 vende vakante, kategoria staf ndihmësakademik me karakter administrativ: 1 pozicion: "*Specialist i Kurrikulave*", pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë; dhe një pozicion "*Asistent i Rektorit*".

**SPECIALIST I KURRIKULAVE**

**I. Kriteria të përgjithshme:**

Kandidatët për pozicionin Specialist i Kurrikulave, duhet të plotësojnë këto **kriteria të përgjithshme**:

- a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. Të zotërojnë aftësitë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- c. Të kenë aftësitë e punës në grup dhe të komunikimit profesional;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- e. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
- f. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- g. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- h. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.

**II. Kriteret specifike:**

Kandidatët për pozicionin Specialisti i Kurrikulave, duhet të plotësojnë këto **kritere specifike**:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; program studimi i integruar i ciklit të dytë; program studimi i nivelit të dytë; ose program studimi 4- vjeçar*) **me mesatare jo më të ulët se 7 (shtatë)**. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse.
2. Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), me nivel jo më të ulët se B1, (notë jo më të ulët se 7), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
3. Të ketë jo më pak se 2 vite eksperiencë pune në administratën publike;
4. Preferohet që kandidatët:
  - të kenë eksperiencë pune të ngjashme
  - të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
  - të kenë aftësi të mira kompjuterike;

### III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin Specialist i Kurrikulave duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
- b. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
- c. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (*Bachelor*; dhe *MSC*, sistemi 4- vjeçar; *DIND* ose program studimi të nivelit të dytë) dhe suplementet përkatëse të notave, të noterizuara. *Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.*
- d. Rekomandim ose leter referencë nga punëdhënësi i fundit.
- e. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore, origjinale ose kopje të noterizuara.
- f. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
- g. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjykatë dhe vërtetim nga prokuroria, të lëshuara brenda 3- muajve të fundit.
- h. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë të lëshuar brenda 3- muajve të fundit.
- i. Kopje e noterizuar e librezës së punës dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë.

- j. deklaratë personale që dëshmon për moslidhje familjare, (neni 5, pika 3/c) dhe që kandidati nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- k. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

**Legjislacioni rreth të cilit do të zhvillohet faza e dytë e konkurimit për pozicionin "Specialist i Kurrikulave", intervista me gojë, do të bazohet në:**

1. Ligji Nr. 7961, datë 12. 7. 1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
3. VKM Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", i ndryshuar.
4. Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", miratuar me Urdhër të MAS nr 366, datë 05. 07. 2018, i ndryshuar;
4. Udhëzimi i MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.

## **ASISTENT I REKTORIT**

### **I. Kriteria të përgjithshme:**

Kandidatët për pozicionin "Asistent i Rektorit", duhet të plotësojnë këto **kriteria të përgjithshme**:

- a. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. Të zotërojnë aftësitë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
- c. Të kenë aftësitë e punës në grup dhe të komunikimit profesional;
- d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- e. Të mos jenë larguar nga USH-ja pa miratimin e këtij fundit;
- f. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/ bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijet e tyre); gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijet e tyre), me punonjës brënda të njëjtës njësi ku kërkojnë të punësohen, si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", (i ndryshuar).
- g. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- h. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH-së.

## II. Kriteret specifike:

Kandidatët për pozicionin “Asistent i Rektorit”, duhet të plotësojnë këto **kritere specifike**:

- a. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit, në sistemin me kohë të plotë (*Bachelor*) dhe (*Master i Shkencave; program studimi i integruar i ciklit të dytë; program studimi i nivelit të dytë; ose program studimi 4- vjeçar*) **me mesatare jo më të ulët se 7 (shtatë)**. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet *certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse*.
- b. Të njohë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), me nivel jo më të ulët se B1, (notë jo më të ulët se 7), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore.
- c. Të ketë jo më pak se 2 vite eksperiencë pune në administratën publike;
- d. Preferohet që kandidatët:
  - të kenë eksperiencë pune të ngjashme
  - të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
  - të kenë aftësi të mira kompjuterike;

## III. Dokumentacioni:

Kandidatët për pozicionin “Asistent i Rektorit”, duhet të dorëzojnë me postë drejtuar Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesë me shkrim për punësim në USH.
- b. Jetëshkrim (CV) me foto personale.
- c. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (*Bachelor*; dhe *MSC*, sistemi 4-vjeçar; *DIND* ose program studimi të nivelit të dytë) dhe suplementet përkatëse të notave, të noterizuara. Për *diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR*.
- d. Rekomandim ose leter referencë nga punëdhënësi i fundit.
- e. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore, origjinale ose kopje të noterizuara.
- f. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
- g. Dëshmi e gjendjes gjyqësore, vërtetim gjyqësor dhe vërtetim nga prokuroria, të lëshuara brenda 3- muajve të fundit.
- h. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë të lëshuar brenda 3- muajve të fundit.



- i. Kopje e noterizuar e librezës së punës dhe/ose çdo dokumentacion tjetër ligjor, që provon eksperiencën në punë.
- j. deklaratë personale që dëshmon për moslidhje familjare, (neni 5, pika 3/c) dhe që kandidati nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (i ndryshuar).
- k. Fotokopje e pasaportës ose kartës ID.

**Legjislacioni rreth të cilit do të zhvillohet faza e dytë e konkurimit, intervista me gojë, për pozicionin “Asistent i Rektorit” do të bazohet në:**

1. Ligji Nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Statuti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, miratuar me Urdhër të MAS nr 366, datë 05. 07. 2018, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
5. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

**V.O:**

- Kandidatët duhet të dorëzojnë **me postë** dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda **14 ditëve kalendarike** nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Mosplotësimi i kriterëve të përcaktuara apo mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në këtë shpallje, (me përjashtim të kriterëve të përcaktuara si preferenciale) përbën shkak për skualifikimin e kandidatëve.

-Konkursi do të zhvillohet në dy faza:

**Faza I:** Vlerësimi i dokumentacionit dhe;

**Faza II.** Intervista me gojë.

- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc për kualifikimin apo skualifikimin e tyre.

- Ankimimet mund të bëhen brenda 5 (pesë) ditëve punë nga shpallja e rezultatit.

**REKTORI**  
  
**Prof. dr. Dini Gjura**